

Zjarre në ambient të hapur dhe zjarre në pyje

Zjarri në ambient të hapur është çdo djegie e pakontrolluar e pyllit dhe në tokë pyjore, i cili përfshin edhe djegie të sipërfaqes bujqësore dhe të kullotave, pa dallim se sa është përfshirja e sipërfaqes, intensitetit dhe arsyeve për paraqitjen e tij.



Shkaqet dhe faktorët e paraqitjes së zjarreve

Në 99% të rasteve zjarret paraqiten për shkak të gabimit të njeriut. Njerëzit shkaktojnë zjarr me qëllim apo nga mosdija. Analizat tregojnë se 65% të zjarreve të krijuara janë shkaktuar nga pakujdesia. Një numër më i vogël i zjarreve shkaktohet nga goditja e rrufesë apo nga ndikime të tjera natyrore.

T'i ruajmë pyjet që edhe ata të na ruajnë neve!

- Mos hidhni cigare të ndezura apo mbetje të cigareve të ndezura në ambient të hapur;
- Mos ndizni skarë në ambient të hapur dhe në afërsi të një pylli;
- Mos lejoni fëmijët të luajnë me çakmakë, zjarr dhe prush;
- Mos përdorni në ambiente të hapura gjëra të cilat mund të shkaktojnë zjarr;
- Mos lini mbeturina në pyll për shkak të mundësisë së vetëndezjes;
- Mos i digjni arat e korrura;
- Mos digjni kullota dhe lëndina;
- Respektoni urdhrat e organeve kompetente për ndalesë të ndezjes së zjarrit në një ambient të hapur në periudhën e rreziqeve të shtuara nga zjarri;
- Respektoni shenjat e ndalesës së qasjes në rajonet ku ka rrezik të madh nga zjarri;
- Duhet ta keni parasysh se zjarri fillestar shuhet me një gotë ujë.



Në rast se shtëpia juaj gjendet në një zonë pyjore ose në afërsi të ndonjë pylli, përpiquni që:

- Në radius prej 20 metrave rreth shtëpisë t'i preni bimët e ulëta, t'i pastroni dhe t'i largoni: barin e thatë, gjethet dhe degët;
- Ta mirëmbani oborrin – t'i largoni gjethet dhe degët e thata, të mos lejoni që degët t'i prekin muret e shtëpisë, as kulmet dhe ballkonet;
- Mos mbani materie ndezëse në afërsi të shtëpisë;
- Furnizohuni me aparate përkatëse për shuarjen e zjarrit dhe mirëmbajini ata;
- Sigurohuni me çezma të lidhura me ujësjellës dhe me zorrë për ujë me gjatësi të mjaftueshme për ta mbuluar territorin apo sipërfaqen të cilën dëshironi ta mbron, si dhe rezervuarë me ujë dhe pompë joelektrike për ujë.

Reagimi në rast zjarri

Në rast se vëreni zjarr:

- Telefononi numrin 193 dhe jepuni informata të sakta për vendin e saktë të zjarrit;
- Përshkruani si është vegjetacioni i cili është përfshirë nga zjarri;
- Tregoni nëse në afërsi ekzistojnë magazina me materie të rrezikshme;
- Tregojeni drejtimin në të cilin përhapet zjarri dhe
- Mos e ndërprisni telefonatën përderisa t'i jepni të gjitha informatat e nevojshme.



Në rast se zjarri është në afërsi të shtëpisë suaj:

- Mos u largoni nga shtëpia, përveç nëse jeni tërësisht të sigurt se mund të largoheni në mënyrë të sigurt. Është mundësia e madhe që të mbijetohet në objekte banuese të cilat janë ndërtoar me materiale të cilat nuk digjen;
- Vendosni në shtëpi të gjithë anëtarët e familjes dhe kafshët shtëpiake;
- Mbyllni të gjitha dritaret dhe dyert dhe mbyllni vrimat me pëlhurë të lagur;
- Largojuini perdet nga dritaret;
- Vendosni mbylljet në mes të dhomës, më larg dritareve;
- Mbyllni të gjitha dyert brenda shtëpisë;
- Sigurojeni rezerva me ujë;
- Mblidhuni të gjithë në një vend;
- Mbanini me vete një lambë me bateri në rast se vjen deri të ndërprerja e furnizimit me energji elektrike.

Në rast se zjarri përhapet drejt shtëpisë suaj:

- Qëndroni të qetë;
- Të gjitha materiet e ndezshme të cilat gjenden në afërsi të shtëpisë suaj zhvendosini në vende të mbyllura ose të mbrojtura, që të mos shkaktohet një përhapje plotësuese e zjarrit;
- Mbyllni të gjitha furnizimet me gaz apo me karburante në afërsi të objektit;
- Mundësojuni qasje automjeteve zjarrfikëse;
- Ndizni dritat brenda dhe jashtë për të pasur një dukshmëri më të madhe nëpër tym, në rast se është zvogëluar dukshmëria.

Këshilloheni që të bëhet evakuim vetëm në raste të domosdoshme në drejtime të cilat nuk janë të rrezikuara nga zjarri dhe tymi, sipas udhëzimeve të shërbimeve kompetente.

Pasi të shuhet zjarri:

- Dilni nga shtëpia dhe shuani menjëherë pikat e mbetura me zjarr në afërsi;
- Bëni kujdestari derisa të gjitha burimet e mundshme të zjarrit nuk shuhet, për shkak të mundësisë për t'u paraqitur zjarre më të vogla në afërsi të shtëpisë/ndërtesës dhe të ndizet përsëri.

Pasoja nga zjarret

Pasoja nga zjarret në pyje varen nga lloji i zjarrit, kohëzgjatja e zjarrit, llojit të pyllit dhe madhësisë së sipërfaqes së përfshirë me zjarr. Zjarret shkaktojnë dëm material, por edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë kanë ndikim të dëmshëm mbi ambientin jetësor dhe e ulin rezistencën e pyjeve dhe biodiversitetin e tyre.

Mbajeni mend: Cigarja e ndezur është shkaktori më i shpeshtë i zjarreve në pyje. Kurrë mos e hidhni cigaren nga makina në lëvizje. Kur jeni në natyrë, mbeturinat e cigareve apo mbetjen e cigares së ndezur shuajini gjithmonë me kujdes.

PËRGATITUNI PËR ZJARRET PYJORE PARA SE TË SULMOJNË ATA, DUKE NDJEKUR KËTO UDHËZIME:

30m
KRUJONI NJË HAPËSIRË MBROJTËSE: NEVOJITEN 30 METRA HAPËSIRË MBROJTËSE RRETH SHTËPISË SUAJ. MËSOHUNI T'I RUANI TË SIGURTA DY ZONAT RRETH SHTËPISË SUAJ.

në 1 km
MBROJENI SHTËPINË TUAJ. GAÇAT FLUTURUESE MUND T'I SHKATËRROJNË SHTËPITË TUAJA DERI NË 1 KILOMETËR NGA FUSHA E PËRFSHIRË ME ZJARR. MËSOHUNI SE SITA MBRONI SHTËPINË TUAJ NGA RREZIKU I ZJARRIT PYJOR.

1. ÇKA
2. SI
3. KË
4. KUR

PËRGATITENI SHTËPINË DHE FAMILJEN TUAJ NËSE ËSHTË I DOMOSDOSHËM EVAKUIMI.

BËNI NJË PLAN AKSIONI PËR ZJARRET PYJORE.

PËRGATISNI NJË ÇANTË PËR NDIHMË URGJENTE.

KRUJONI NJË PLAN FAMILJAR PËR KOMUNIKIM.

LARGOHU!

HAPAT PËR EVAKUIMIN: PËRGATITENI PËR PËRSHIRËT E BRENDSHME DHE TË JASHTME TË SHTËPISË SUAJ PËR EVAKUIM.

SHIKOJENI LISTËN E PLANIT PËR EVAKUIM.

HAPAT E EVAKUIMI: KUR ËSHTË I DOMOSDOSHËM EVAKUIMI, PËRGATITUNI TË LARGOHESH.

SIGUROHU SE ÇANTA PËR NDIHMË URGJENTE ËSHTË NË MAKINËN TUAJ.

MBROHUNI NGA NXEHTËSIA DHE GAÇAT FLUTURUESE. VISHNI PANTOLLONA TË GJATA, BLUZË ME MËNGË TË GJATA, MBATHJE TË RËNDË / ÇIZME, KAPELË, NJË FAÇOLETË TË THATË PËR TA MBULLUR FYTYRËN DHE SYZE MBROJTËSE. REKOMANDOHET QË VESHJA TË JETË ME 100% PAMBUK.

GJEJINI KAFSHËT E SHTËPISË DHE MERRINI ME VETE.

rr. "Vasko Karangeleski"
nr. 8, 1000 Shkup
tel. 02/2433-384
faks: 02/2433 300
ueb-faqja: www.dzs.gov.mk
e-mail: dzs@dzs.gov.mk
dhe press@dzs.gov.mk



Mbështetur nga:
EVN

QEVERIA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT
DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM



DORÇAÇAK
PËR ZVOGËLIMIN E
KËRCËNIMEVE NGA ZJARRET